

IPKO Foundation

**Raporti i auditorit të pavarur dhe
pasqyrat financiare për vitin e
përfunduar më 31 dhjetor 2020**

Përbajtja	Faqe
Raporti i auditorit të pavarur	1
Pasqyra e pozicionit finansiar	3
Pasqyra e tepricës ose deficitit dhe të ardhurave tjera gjithëpërftirëse	4
Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet	5
Pasqyra e rrjedhës së parasë	6
Shënimë mbi pasqyrat financiare të Organizatës	7-16

RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR

Për Kuvendin e Anëtarëve të Ipko Foundation

Opioni

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Ipko Foundation ("Organizata"), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financier më 31 dhjetor 2020, pasqyrën e tepricave apo deficitit dhe të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse, pasqyrën e bilancit të fondeve dhe pasqyrën e rrjedhës së parasë për vitin që përfundoi me këtë datë, dhe shënimet tjera shpjeguese për pasqyrat financiare duke përfshirë një përbledhje të politikave të rëndësishme të kontabilitetit.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare shoqëruar paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financier të Organizatës më 31 dhjetor 2020, si dhe performancën financiare dhe rrjedhën e parasë për vitin e përfunduar me këtë datë, në përputhje me bazën e përgatitjes sipas përshkrimit në shënimin sqarues 2 dhe Ligjin Nr. 04/L-57 për lirinë e asocimit në organizatat jo-qeveritare.

Bazat për opinion

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar më tej në seksionin e raportit Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Ne jemi të pavarur nga Organizata në përputhje me Kodin e Etikës për Kontabilistët Profesionistë (Kodit IESBA) dhe kemi përbushur përgjegjësitë tjera etike në përputhje me Kodin IESBA. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të ofruar bazat për opinionin tonë.

Theksimi i çështjes - Bazat e kontabilitetit dhe kufizimi mbi shpërndarjen

Ne tërheqim vëmendjen në shënimin 2 të pasqyrave financiare, që përshkruan bazën e kontabilitetit. Pasqyrat financiare janë përgatitur me qëllim të raportimit në Zyrën e OJQ-ve në Kosovë dhe tek donatorët e Organizatës. Si rezultat, pasqyrat financiare mund të mos janë të përshtatshme për ndonjë qëllim tjetër. Raporti ynë është i dedikuar vetëm për Organizatën, Zyrën e OJQ-ve në Kosovë dhe donatorët e Organizatës dhe nuk duhet t'u shpërndahet palëve tjera përveç Organizatës, Zyrës së OJQ-ve në Kosovë dhe donatorëve të Organizatës. Opinion iynë nuk është i modifikuar në lidhje me këtë çështje.

Përgjegjësitë e menaxhmentit dhe personave të ngarkuar me qeverisjen për pasqyrat financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në pajtueshmëri me bazën e kontabilitetit të përshkruar në shënimin 2 dhe për kontrolllet e brendshëm të cilat menaxhmenti i vlerëson të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa gabime materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Organizatës për vazhdueshmërinë në të ardhmen, duke shpalosur, sipas nevojës, çështjet lidhur me vazhdueshmërinë në të ardhmen dhe përdorimit të parimit të vazhdueshmërisë së kontabilitetit përveç nëse menaxhmenti synon të likuidojë Organizatën apo të ndërpres operimin, apo nuk ka ndonjë alternativ tjetër të mundshme përveç se të bëjë atë.

Ata të cilët janë ngarkuar me qeverisje janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financier të Organizatës.



Përgjegjësitë e auditorit për auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë për të marrë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi janë të lira nga gabimet materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të nxjerë një raport të auditorit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është nivel i lartë i sigurisë, por nuk ka garanci që një auditim i kryer në përputhje me SNA-të gjithmonë do të zbulojë gabime materiale kur ato ekzistojnë. Gabimet mund të rrjedhin nga mashtrimet apo gabimet dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose në total, ato në mënyrë të arsyeshme mund të pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra mbi bazën e këtyre pasqyrave financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe mbajmë skepticizmin profesional gjatë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e gabimeve materiale në pasqyrat financiare, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dizajnojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit të përshtatshme për këto rreziqe, dhe marrim dëshmi të auditimit të mjaftueshme dhe e përshtatshme për të ofruar bazat për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të gabimeve materiale që rezulton nga mashtrimi është më i lartë se atij që rrjedh nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keqinterpretim, apo shkelje të kontolleve të brendshme.
- I kuptojmë kontrolllet e brendshme relevante për auditimin me qëllim të hartimin të procedurave të auditimit që janë të përshtatshme në rrethanat, por jo për qëllim të shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontolleve të brendshëm të Organizatës.
- I vlerësojmë përshtatshmérinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmérin e vlerësimeve kontabël dhe shpalosjet relevante të bëra nga menaxhmenti.
- Konkludojmë mbi përshtatshmérinë e përdorimit të parimit te vazhdueshmërisë së kontabilitetit nga menaxhmentit, duke u bazuar në dëshmitë e siguruara të auditimit, nëse një pasiguri materiale ekziston në lidhje me ngjarjet apo kushteve që mund të hedhë dyshime të konsiderueshme mbi aftësinë e Organizatës për të vazhduar në vijimësi. Nëse arrijmë në përfundimin se një pasiguri materiale ekziston, ne jemi të detyruar të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit për shpalosjet relevante në pasqyrat financiare apo, nëse shpalosjet e tillë janë të papërshtatshme, të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencat e auditimit të marra deri në datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojë që Organizata të pushojë së vazhduari në vijimësi.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në to në një mënyrë që arrin paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen e kompanisë, në mes tjerash, edhe për fushëveprimin e planifikuar dhe kohën e auditimit, si dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, duke përfshirë çdo mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që identifikojmë gjatë auditimit.

BDO Kosova L.L.C.

BDO Kosova L.L.C.

Rr. Ukshin Hoti, Ob.C4/3, Hy.A, Kati II, Prishtinë

22 mars 2021

BDO

BDO Kosova L.L.C.
audit, accounting and financial advisor
Prishtina, Kosovo

Burim Cena,
Partner i angazhimit

IPKO Foundation
 Pasqyra e pozicionit finansiar
Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2020
 (Të gjitha shumat janë të shprehura në EURO)

	Shënimi	Më 31 dhjetor 2020	Më 31 dhjetor 2019
Pasuritë			
Pasuritë jo-qarkulluese			
Prona, impiantet dhe pajisjet	4	16,428.49	27,053.62
Depozita të afatizuara	5	1,500,000.00	1,500,000.00
Gjithsej pasuritë jo - qarkulluese:		<u>1,516,428.49</u>	<u>1,527,053.62</u>
Pasuritë qarkulluese:			
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	6	463,919.24	551,951.68
Parapagimet dhe të arkëtueshmet tjetra	7	44,055.36	2,745.39
Gjithsej pasuritë qarkulluese:		<u>507,974.60</u>	<u>554,697.07</u>
Gjithsej pasuritë		<u>2,024,403.09</u>	<u>2,081,750.69</u>
Bilanci i fondit dhe detyrimet			
Bilanci i fondit			
Teprica e akumuluar		2,038,614.36	2,173,278.39
Deficiti për vitin		(99,948.13)	(134,664.03)
Gjithsej bilanci i fondit		<u>1,938,666.23</u>	<u>2,038,614.36</u>
Detyrimet afatshkurtra			
Llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjetra	8	24,713.37	8,220.56
Të hyrat e shtyra	9	61,023.49	34,915.77
Gjithsej detyrimet afatshkurtra		<u>85,736.86</u>	<u>43,136.33</u>
Gjithsej bilanci i fondit dhe detyrimeve		<u>2,024,403.09</u>	<u>2,081,750.69</u>

Këto pasqyra financiare u autorizuan dhe u nënshkruan në emër të menaxhmentit me datë 22 mars 2021.



Arbresha Tuhina
 Kontabiliste e certifikuar

Shënimet shoqëruese nga 1 deri 17 janë pjesë përbërëse të këtyre pasqyrave financiare.

IPKO Foundation

Pasqyra e tepricës ose deficitit dhe të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse

Për vitin që ka përfunduar më 31 dhjetor 2020

(Të gjitha shumat janë të shprehura në EURO)

	Notes	Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2020	Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019
Fonde nga donatorët	10	341,503.39	363,978.58
Të hyrat nga interesë	11	37,501.40	40,159.61
Gjithsej të hyra		379,004.79	404,138.19
Shpenzime tjera operative	12	(288,798.96)	(358,559.61)
Shpenzime të personelit	13	(179,528.83)	(167,731.59)
Shpenzime të zhvlerësimit	4	(10,625.13)	(12,511.02)
Përdorimi i fondeve		(478,952.92)	(538,802.22)
Deficiti për vitin		(99,948.13)	(134,664.03)
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse		-	-
Gjithsej deficit për vitin		(99,948.13)	(134,664.03)

Shënimet shoqëruese nga 1 deri 17 janë pjesë përbërëse të këtyre pasqyrave financiare.

IPKO Foundation
Pasqyra e bilancit të fondeve
Për vitin që ka përfunduar më 31 dhjetor 2020
(Të gjitha shumat janë të shprehura në EURO)

	Teprica e akumuluar	Gjithsej
Gjendja më 1 janar 2019	2,173,278.39	2,173,278.39
Deficiti për vitin	(134,664.03)	(134,664.03)
Të ardhurat tjera gjithpërfshtirëse	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2019	2,038,614.36	2,038,614.36
Deficiti për vitin	(99,948.13)	(99,948.13)
Të ardhurat tjera gjithpërfshtirëse	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2020	1,938,666.23	1,938,666.23

Shënimet shoqëruese nga 1 deri 17 janë pjesë përbërëse të këtyre pasqyrave financiare.

IPKO Foundation
 Pasqyra e rrjedhës së parasë
 Për vitin që ka përfunduar më 31 dhjetor 2020
(Të gjitha shumat janë të shprehura në EURO)

	Shënimi	Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2020	Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019
Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative			
Deficiti për periudhën		(99,948.13)	(134,664.03)
<i>Rregullime për:</i>			
Zhvlerësimi	4	10,625.13	12,511.02
Të hyrat nga interesit	11	(37,501.40)	(40,159.61)
		<u>(126,824.40)</u>	<u>(162,312.62)</u>
Lëvizja në kapitalin punues:			
Rritja/(Zvogëlimi) në parapagime	7	(41,309.97)	540.00
Rritja/(zvogëlimi) në të hyra të shtyera	9	26,107.72	(66,077.53)
Rritja në detyrime	8	16,492.81	4,565.98
Interesi i pranuar		<u>37,501.40</u>	<u>40,159.61</u>
Paraja neto e përdorur në aktivitet operative		<u>(88,032.44)</u>	<u>(183,124.56)</u>
Rrjedha e parasë nga aktivitetet investuese			
Blerja e aseteve	4	-	(1,202.85)
Paraja neto e përdorur në aktivitet investuese		<u>-</u>	<u>(1,202.85)</u>
Rrjedha e parasë nga aktivitetet financiare			
Ndryshime në depozita		-	400,000.00
Paraja neto e përdorur në aktivitet financiare		<u>-</u>	<u>400,000.00</u>
Rritja neto në para dhe ekuivalentët e saj		<u>(88,032.44)</u>	<u>215,672.59</u>
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fillim të vitit	6	551,951.68	336,279.09
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fund të vitit	6	<u>463,919.24</u>	<u>551,951.68</u>

Shënimet shoqëruarë nga 1 deri 17 janë pjesë përbërëse të këtyre pasqyrave financiare.

IPKO Foundation
Shënimet mbi pasqyrat financiare
Për vitin që ka përfunduar më 31 Dhjetor 2020
(Të gjitha shumat janë të shprehura në EURO)

1. Informatat të përgjithshme

IPKO Foundation (“Organizata” ose “Fondacioni”) është pasardhës i Institutit IPKO dhe është organizatë jo-fitimprurëse e themeluar me 15 shkurt 2000 në përputhje me Administratën e Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) - Rregullorja Nr. 1999/22.

Organizata është themeluar për të ndihmuar të sigurojë mjetet, njohuritë dhe ambientin e nevojshme për Kosovën, që të marrë pjesë në shoqërinë globale të informacionit. Organizata ofron shërbime të internetit (“ISP”) falas, përmes bashkëpuntorët të saj IPKO Net (“Associate”), për një numër të organizatave jo-qeveritare.

Më 3 prill 2008, Asambleja e Përgjithshme e Institutit Ipko ka ndryshuar misionin dhe qëllimin e organizatës, nga një ofrues të shërbimit të internetit të lirë në një institucion që ofron bursa për studentët e kualifikuar në Kosovë.

Më 20 qershor 2008 Kuvendi i Përgjithshëm i Institutit IPKO ka vendosur unanimisht për të ndryshuar emrin e Institutit në Ipko Foundation. Ky ndryshim i emrit është bërë për të reflektoar më mirë ndryshimin në misionin e Fondacionit dhe nuk përfshinë ndryshimi në strukturën ligjore, Fondacioni mbetet organizatë jo-fitimprurëse.

Më 31 dhjetor 2020, Organizata ka 17 punëtorë të rregullt (2019: 17 punëtorë të rregullt).

2. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me kërkesat e Ligjit nr.04/L-57 për Lirinë e Asocimit në Organizatat Jo-qeveritare me qëllim të raportimit në zyrën e OJQ-ve.

Të hyrat ng grantet njihen kur fitohen e jo kur janë pranuar dhe shpenzimet njihen kur ndodhin e jo kur paguhen.

Grantet nuk njihen derisa të kenë siguri të arsyeshme se Organizata do të jetë në përputhje me kushtet e bashkëngjitura me to dhe se granti do të merret përvèq kësaj, detyrimet e shtyra të granteve, parapagimet dhe detyrimet tjera regjistrohen në bazë të përllogaritjes së kontabilitetit. Politikat e rëndësishme të kontabilitetit janë përshkruar më poshtë.

IPKO Foundation
Shënimet mbi pasqyrat financiare
Për vitin që ka përfunduar më 31 dhjetor 2020
(Të gjitha shumat janë të shprehura në EURO)

3. Përbledhje e politikave të rëndësishme të kontabilitetit

3.1 Baza e përgatitjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur në bazë të kostos historike. Politikat kryesore kontabël janë paraqitur më poshtë.

3.2 Valuta e paraqitur

Valuta raportuese e organizatës është Euro, që është monedha ligjore në territorin e Kosovës që nga 1 Janari 2002.

3.3 Valutat e huaja

Transaksionet në valutë të huaj janë shkëmbyer në monedhën funksionale duke përdorur kursin e këmbimit ekzistues në datat e transaksioneve. Aktivet dhe detyrimet në valuta të huaja monetare konvertohen në valutën funksionale me kursin e këmbimit në datën e raportimit. Artikuj jo-monetary që janë matur në terma të kostos historike në monedhë të huaj nuk rivlerësohen.

3.4 Prona, impiatet dhe pajisjet

i. Njohja dhe matja

Zërat e pronave dhe pajisjeve vlerësohen me koston minus amortizimin e akumuluar dhe çdo humbje nga zhvlerësimi. Kosto përfshin shpenzime që janë drejtpërdrejtë të ngarkueshme për blerjen e asetit. Kur pjesë të një elementi të aseteve të ndryshme afatgjata materiale kanë jetëgjatësi të dobishme të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra (përbërsit madhor) të pronës, impianteve dhe pajisjeve. Fitimet dhe humbjet nga shitja e pajisjeve janë të përcaktuara duke iu referuar vlerës kontabël dhe janë marrë parasysh në përcaktimin e rezultatit operativ për periudhën.

ii. Kostot pasuese

Kostoja e zëvendësimit të një pjesë të ndonjë zëri të pronës, impianteve dhe pajisjeve është njohur në vlerën kontabël të pasurisë pjesa e së cilës zëvendësohet nëse është e mundur që përfitimet e ardhshme ekonomike të trupëzuara përbrenda pjesës do të rrjedhin në Organizatë dhe kostoja e saj mund të matet me besueshmëri. Kostot e mirëmbajtjes së përditshme të pronës, impianteve dhe pajisjeve janë njohur në pasqyrën e burimeve dhe shfrytëzimit të fondeve dhe të ardhurave tjera gjithpërfshirëse kur kanë ndodhur.

iii. Zhvlerësimi

Zhvlerësimi njihet në pasqyrën e burimeve dhe shfrytëzimit të fondeve dhe të ardhurave tjera gjithpërfshirëse mbi bazën e metodës lineare përgjatë jetës së dobishme të vlerësuar të secilës pjesë të zërave të pronës dhe pajisjeve.

Shkallët e zhvlerësimit, duke u bazuar në jetëgjatësinë për periduhat aktuale dhe krahasuese, janë të paraqitura më poshtë:

	Më 31 dhjetor 2020	Më 31 dhjetor 2019
Pajisjet	20%	20%
Investimet në zyre	50%	50%
Vetura	20%	20%

3. Përbledhje e politikave të rëndësishme të kontabilitetit (vazhdim)

3.5 Paraja dhe ekivalenet e parashë

Paraja dhe ekivalenet e parashë përfshijnë paratë në arkë, depozitat e mbajtura në banka dhe investime afat-shkurtër likuide me afat maturimi më pak se tre muaj kur blihen dhe janë subjekt i një rreziku më të vogël të ndryshimeve në vlerë.

3.6 Të arkëtueshmet dhe tregtaret tjera

Të arkëtueshmet tregtare paraqiten me kostot të amortizuar duke përdorur metodën e interest efektiv, më pak për lejimin për borxhet e dyshimta.

3.7 Të pagueshmet dhe tregtaret tjera

Të pagueshmet tregtare dhe të pagueshmet tjera maten në kosto e cila është vlera e drejtë e shumës për t'u paguar në të ardhmen për mallrat dhe shërbimet e pranuara pa marrë parasysh se a i janë faturuar Organizatës apo jo.

3.8 Grantet

Grantet nuk njihen derisa të kenë siguri të arsyeshme se Organizata do të jetë në përputhje me kushtet e bashkëngjitura me to dhe se granti do të merret.

Grantet qeveritare njihen në pasqyrën e burimeve dhe shfrytëzimit të fondevë dhe të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse në baza sistematike gjatë periudhave në të cilat Organizata njeh si shpenzime kostot e lidhura, për të cilat kanë për qëllim për të kompensuar. Në mënyrë të veçantë, grantet kusht primar i të cilave është se Organizatës i duhet të blejë, ndërtoj ose të marrë aktivet afatgjata njihen si të ardhura të shtyera në pasqyrën e pozicionit financiar dhe transferohen në pasqyrën e burimeve dhe shfrytëzimit të fondevë dhe të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse në baza sistematike dhe racionale gjatë jetës së dobishme pasurive të lidhura.

Grantet që janë të arkëtueshme si kompensim për shpenzimet ose humbjet tashmë të ndodhura ose për qëllim të dhënies së mbështetjes financiare të mënjerëhershme për Organizatën e pa shpenzime të lidhura në të ardhshme njihen në pasqyrën e burimeve dhe shfrytëzimit të fondevë dhe të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse në periudhën në të cilën ato bëhen të arkëtueshme.

3.9 Rënia në vlerë

Pasuritë jo-financiare

Vlerat kontabël të pasurive të Organizatës, me përjashtim të inventarëve, rishikohen në çdo datë të raportimit për të përcaktuar nëse ka ndonjë tregues për rënie në vlerë. Nëse ekziston ndonjë tregues i tillë, vlera e rikuperueshme e aktivit vlerësohet.

Një humbje nga zhvlerësimi njihet kur vlera kontabël e një aktivi ose njësia e saj gjeneruese e parave tejkalon shumën e rikuperueshme. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave.

Për një aktiv që nuk gjeneron hyrje të parave kryesisht të pavarura, shuma e rikuperueshme përcaktohet për njësinë gjeneruese të parave të cilës i përket aseti. Në lidhje me pronën, bimët dhe pajisjet, një humbje nga zhvlerësimi kthehet nëse ka pasur një ndryshim në vlerësimet e përdorura për të përcaktuar shumën e rikuperueshme.

3. Përbledhje e politikave të rëndësishme të kontabilitetit (vazhdim)

3.10 Interesi

Të hyrat dhe shpenzimet e interesit njihen në pasqyrën e burimeve dhe shfrytëzimit të fondeve dhe të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse duke përdorur metodën e interesit efektiv. Norma e interesit efektiv është norma që skonton pagesat e vlerësuarë të parave në të ardhmen dhe arkëtimet përgjatë jetës së pasurisë ose detyrimit financiar (ose kur është e përshtatshme, një periudhë më të shkurtër) deri në vlerën kontabël të pasurisë ose detyrimit financiar. Norma efektive e interesit është krijuar në njohjen parësore të pasurisë dhe detyrimit financiar dhe nuk është rishikuar më pas. Kalkulimi i normës efektive të interesit përfshin të gjitha tarifat dhe pikat e paguara ose kostot e transaksioneve të pranuara dhe zbritjet ose premitë që janë pjesë integrale e nomrës efektive të interesit. Kostot e transaksioneve përfshinë kostot shtesë të lidhura drejtëpërdrejtë me blerjen, emetimin ose shlyerjen e një pasurie apo detyrimi financiar.

Të hyrat dhe shpenzimet e interesit të paraqitura në pasqyrën e burimeve dhe shfrytëzimit të fondeve dhe të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse përfshijnë interesin në pasuri dhe detyrime financiare me koston e amortizuar mbi bazën e normës efektive të interesit.

3.11 Përfitimet e punëtorëve

Organizata nuk bën asnjë provizon dhe nuk ka asnjë obligim për pensionet e punonjësve mbi dhe përtej kontributeve të paguara në Trustin e Kursimeve Pensionale të Kosovës.

3.12 Kontigencat dhe provizonet

Detyrimet kontigjente nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato shpalosen përvèç nëse mundësia e rrjedhës së mjeteve që trupëzojnë përfitime ekonomike është e largët. Një pasuri kontigjente nuk njihet në pasqyrat financiare por shpaloset kur hyrja e përfitimeve ekonomike është e mundshme.

Një provision njihet nëse Kompania ka një detyrim actual (ligjor ose konstruktiv) si rezultat i një ngjarje të kaluar, është e mundshme që një dalje e mjeteve që trupëzojnë përfitime ekonomike do të kërkohet për të shlyer detyrimin dhe mund të bëhet një vlerësim i besueshëm i shumës së obligimit.

3.13 Tatimi në fitim

Sipas Ligjit Nr.06/L-105 mbi Tatimin në Korporata, si Fondacion jo-fitimprurëse me status të përfituesit publik, Ipko Foundation është përjashtuar nga tatami në të hyra. Një organizatë jo-qeveritare e regjistruar në Kosovë mund të aplikojë për status të përfituesit publik dhe përjashtimit nga tatimi mbi të hyrat. Fondi ka marrë këtë status në dhjetor të vitit 2001.

3.14 Instrumentet financiare jo-derivative

Vlera e drejtë, e cila është e përcaktuar për qëllime të shpalosjes, llogaritë në bazë të vlerës aktuale të principalit dhe monetare të interesit flukseve të ardhshme monetare, të zbritur me normën e tregut të interesit në datën e raportimit.

IPKO Foundation
Shënimet mbi pasqyrat financiare
Për vitin që ka përfunduar më 31 dhjetor 2020
(Të gjitha shumat janë të shprehura në EURO)

3. Përbledhje e politikave të rëndësishme të kontabilitetit (vazhdim)

3.15 Gjykimet kritike dhe burimet kyçe të pasigurisë së vlerësuar

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon që menaxhmenti të bëj gjykime, vlerësimë dhe supozime të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave kontabël dhe shumave të raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto vlerësimë.

Vlerësimet dhe supozimet shqyrtohen në baza të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në periudhat e ardhshme nëse ato ndikohen. Vlerësimi kyç i përdorur nga Fondacioni është zhvlerësimi i llogaritur për pajisje (shënim 4 dhe shënim 3.4).

4. Prona, Impiantet dhe Pajisjet

	Vetura	Pajisjet	Investimet në zyre	Gjithsej
Kosto historike				
Më 1 janar 2019	13,455.68	29,037.90	7,543.46	50,037.04
Shtesat gjatë vitit	-	1,202.85	-	1,202.85
Më 31 dhjetor 2019	13,455.68	30,240.75	7,543.46	51,239.89
Shtesat gjatë vitit	-	-	-	-
Më 31 dhjetor, 2020	13,455.68	30,240.75	7,543.46	51,239.89
Zhvlerësimi i Akumuluar				
Më 1 janar 2019	6,525.07	3,264.31	1,885.87	11,675.25
Zhvlerësimi për vitin	2,691.13	6,048.15	3,771.74	12,511.02
Më 31 dhjetor 2019	9,216.20	9,312.46	5,657.61	24,186.27
Zhvlerësimi për vitin	2,691.13	6,048.15	1,885.85	10,625.13
Më 31 dhjetor, 2020	11,907.33	15,360.61	7,543.46	34,811.40
Vlera neto				
Më 31 dhjetor 2020	1,548.35	14,880.14	-	16,428.49
Më 31 dhjetor 2019	4,239.48	20,928.29	1,885.85	27,053.62

Pajisja u dhurua nga projekti USAID - BEP në Korrik 2016. Të hyrat e shtyera janë të lidhura më këtë pajisje të dhuruar.

Investimi në zyre është zyra e marrë me qira me kontratë dy vjeçare. Zhvlerësimi llogaritet duke u bazuar në kohëzgjatjen e kontratës.

IPKO Foundation
Shënimet mbi pasqyrat financiare
Për vitin që ka përfunduar më 31 dhjetor 2020
(Të gjitha shumat janë të shprehura në EURO)

5. Depozitat e afatizuara

IPKO Foundation ka një depozitë me afat në IS Bank. Depozitat e afatizuara janë një depozitë me afat trevjeçar në shumën prej 1,500,000.00 me normë interesë prej 2.5%.

6. Paraja dhe ekuivalentët e parasë

	Më 31 dhjetor 2020	Më 31 dhjetor 2019
Paraja në bankë	463,919.24	551,951.61
Paraja në arkë	-	0.07
Gjithsej	<u>463,919.24</u>	<u>551,951.68</u>

7. Parapagimet dhe të arkëtueshmet tjera

	Më 31 dhjetor 2020	Më 31 dhjetor 2019
Të arketushme nga donacionet	42,782.87	-
Shpenzimet e parapaguara	1,101.35	2,331.88
Avanset e dhëna për punonjës	171.14	413.51
Gjithsej	<u>44,055.36</u>	<u>2,745.39</u>

8. Llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera

	Më 31 dhjetor 2020	Më 31 dhjetor 2019
Llogaritë e pagueshme tregtare	6,072.79	8,220.56
Detyrime tjera	17,642.58	-
Shpenzime akruale	998.00	-
Gjithsej	<u>24,713.37</u>	<u>8,220.56</u>

IPKO Foundation
Shënimet mbi pasqyrat financiare
Për vitin që ka përfunduar më 31 dhjetor 2020
(Të gjitha shumat janë të shprehura në EURO)

9. Të hyrat e shtyra

	Më 31 dhjetor 2020	Më 31 dhjetor 2019
Të hyrat e shtyra për donacionin nga Ministria e Punëve të Jashtme e Norvegjisë	60,242.84	28,159.20
Të hyrat e shtyra për donacionet nga organizatat e huaja	-	4,414.68
Të hyrat e shtyra (Veturat) Gjithsej	780.65	2,341.89
	61,023.49	34,915.77

10. Fonde nga donatorët

	Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2020	Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019
Fondi nga Ministria e Jashtme Norvegjeze	83,286.17	80,656.43
Fondet nga Organizatat ndërkombëtare	226,529.02	129,715.22
Fonder nga OJQ-të vendore dhe të huaja	7,426.96	100,953.69
Fondet nga UNDP	12,700.00	10,618.20
Fonde nga Qeveria	10,000.00	39,350.00
Donacioni-Vetura	1,561.24	1,561.24
Tjera	-	1,123.80
Gjithsej	341,503.39	363,978.58

11. Të hyrat nga interesë

	Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2020	Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019
Të hyra nga interesë nga depozitat	37,501.40	40,159.61
Gjithsej	37,501.40	40,159.61

IPKO Foundation
 Shënimet mbi pasqyrat financiare
 Për vitin që ka përfunduar më 31 dhjetor 2020
(Të gjitha shumat janë të shprehura në EURO)

12. Shpenzime tjera operative

	Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2020	Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019
Shpenzimet këshilluese, ligjore dhe të auditimit	85,186.96	118,027.87
Shpenzimet e udhëtimit dhe argëtimit	10,215.12	60,515.90
Shpenzimet e marketingut dhe reklamave	32,272.13	16,131.09
Shpenzimet e qiraë	15,824.16	25,558.99
Sponzorizimet	55,164.81	33,636.76
Shpenzimet e përfaqësimit	9,938.78	35,995.33
Shpenzimet për material printues	20,464.25	30,986.25
Furnizimet për zyre	9,433.23	7,438.47
Shoenzimet e stafit	1,735.00	-
Shpenzimet e telekomunikimit	3,133.23	2,011.88
Shërbimet komunale	2,505.60	2,739.98
Shpenzimet e veturës	1,130.68	446.84
Tjera	5,175.06	6,720.01
Shpenzimet e mirëmbajtjes	5,021.38	2,604.58
Shpenzimet e projektit	26,530.15	10,725.07
Blerja e pajisjeve të vogëla	5,068.42	5,020.59
Total	288,798.96	358,559.61

13. Shpenzime e personelit

	Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2020	Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019
Pagat bruto	171,067.22	159,831.75
Kontributi pensional	8,461.61	7,899.84
Total	179,528.83	167,731.59

14. Instrumentet financiare dhe menaxhimi i rizikut

Risku i kredisë

Menaxhmenti ka politika mbi menaxhimin e kredisë dhe ekspozimi ndaj rrezikut të kredisë që të monitorohet në mënyrë të vazhdueshme.

Në datën e raportimit, ekspozimi ndaj rrezikut të kredisë është i përfaqësuar nga paraja dhe depozitat me afat. Nuk është dhënë ndonjë rënie në vlerë për këto ekspozime, pasi menaxhmenti nuk beson se do të pësojë ndonjë humbje. Paraja depozitat mbahen në banka brenda Kosovës.

Ekspozimi maksimal ndaj rizikut të kredisë është përfaqësuar nga shuma bartëse e çdo pasurie financiare në pasqyrën e pozicionit financiar.

Risku i normave të interesit

Në menaxhimin e rrezikut të normës së interesit, Organizata ka për qëllim të zvogëlojë ndikimin e luhatjeve afatshkurtra në fitimet e Organizatës në afat më të gjatë. Organizata i vendos depozitat kryesore të saj në depozitat afatgjata me norma fiksë të interesit, për të minimizuar ndikimin e ndryshimeve të normës së interesit.

Risku i menaxhimit të likuiditetit

Rreziku i likuiditetit është rreziku që Fondacioni nuk do të jetë në gjendje të përbushë detyrimet e saj financiare në kohën e duhur. Qasja e Organizatës për menaxhimin e likuiditetit është të sigurojë, sa më shumë të jetë e mundur, që ajo vazhdimeshit do të ketë likuiditet të mjaftueshëm për të përbushur detyrimet, nën kushte normale dhe të stresuara, pa pësuar humbje të paparanueshme apo pa rrezikuar dëmitimin e reputacionit të Fondacionit.

Zakonisht, Organizata siguron se ajo ka para të mjaftueshme në kerkesat e saj për të përbushur shpenzimet e pritura operative për një periudhë prej 60 ditësh, përfshirë edhe përbushjen e detyrimeve financiare; kjo përashton ndikimin e mundshëm të rrethanave ekstreme që nuk un të parashikohet në mënyrë të aryeshme, të tilla si fatkeqësítë natyrore.

Analiza e ndjeshmërisë

Në menaxhimin e normës së interesit dhe rizikut valuator, Fondacioni përpinqet që të zvogëlojë ndikimin e luhatjeve afatshkurtra në fitimet të Fondacionit. Megjithatë, në afat më të gjatë, ndryshime e përhershme në kurset e këmbimit të valutave të huaja dhe interesit mund të ketë një tepricë/deficit. Më 31 dhjetor 2019 dhe më 31 dhjetor 2018, një nryshim në vlerën e euros kundrejt valutave të tjera të huaja nuk do të ndikonte në gjendjen e Organizatës për shkak se nuk ka mbajtur shuma në monedhë të huaj.

IPKO Foundation
Shënimet mbi pasqyrat financiare
Për vitin që ka përfunduar më 31 dhjetor 2020
(Të gjitha shumat janë të shprehura në EURO)

15. Transaksionet me palët e lidhura

Një palë është e lidhur me një etninë nëse, drejtpërdrejtë ose tërthorazi përmes një ose më shumë ndërmjetësve, pala kontrollon, ose është nën kontroll të përbashkët me njësinë ekonomike, palët kanë një interes në njësinë ekonomike që i jep influencë të rëndësishme mbi etnitët, pala ka kontroll të përbashkët mbi njësinë ekonomike, pala është një pjesëmarje ose pala është një anëtar i personelit drejtues kryesor të njësise ekonomike ose të kompanisë mëmë të tij.

Kompensimet totale të paguara për antarë të bordit të organizatës janë:

	Më 31 dhjetor 2020	Më 31 dhjetor 2019
Pagesa konsulence	24,220.18	28,413.38
Shpenzimet e udhëtimit	2,398.84	6,286.72
Paga ditore (Per diem)	227.64	1,270.85
Akomodimi	-	1,153.03
Total	26,846.66	37,123.98

16. Zotimet dhe kontigjencat

Zotimet

Më 31 dhjetor 2020 dhe 2019, Organizata nuk ka ndonjë zotim.

Kontigjencat

Organizata është e përfshirë në procedurat rutinë ligjore në veprimtarinë e zakonshme të biznesit. Mendimi i menaxhmentit është që rezultati përfundimtar i këtyre padive nuk do të ketë ndonjë efekt material në rezultatet e Organizatës. Nuk ka pasur ndryshime në politika nga viti i kaluar dhe menaxhmenti konsideron se nuk ka fusha kritike të gjykimit.

17. Ngjarjet pasuese

Nuk ka ngjarje të rëndësishme pas datës së raportimit që do kërkonin ndryshime apo shpalosje në pasqyrat financiare.